

## ROLI I INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIMIT NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

*nga Irena ISLAMI – Drejtore Drejtorie,  
botuar në gazetën "Tirana Observer", më 16 maj 2015.*

Në mars të këtij viti u zhvillua në Vjenë Simpoziumi i 23-të, organizuar nga Kombet e Bashkuara dhe INTOSAI (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit) me temë: *"Axhenda e zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për periudhën Post- 2015: Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për zhvillimin e qëndrueshëm"*.

Krahas drejtuesve të tjerë të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), në këtë Simpozium, mori pjesë edhe një delegacion i Kontrollit të Lartë të Shtetit, kryesuar nga Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj.

Simpoziumi drejtohej nga z. Josef Moser, kryetar i Gjykatës Austriake të Audituesve dhe njëherazi Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe z. Wu Hongbo, Nën-Sekretar i Përgjithshëm për Çështjet Social Ekonomike në Kombet e Bashkuara. Punimet e simpoziumit u përshëndetën në ditën e parë të tij nga SH.T.Z. Heinz Fischer, President i Austrisë.

Çështja e parë që u trajtua lidhej me pritshmërinë që kanë parlamentet, qeveritë, Kombet e Bashkuara, organizatat e shoqërisë civile, donatorët, qytetarët etj, në lidhje me rolin që mund të luajnë Institucionet Supreme të

Auditimit (SAI) në zhvillim e qëndrueshëm. U theksua rëndësia e forcimit të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe e rolit të parlamenteve dhe rëndësia vitale që ka monitorimi dhe raportimi në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Çështja e dytë lidhej me parakushtet që duhet të plotësojnë SAI-et për t'u angazhuar në mënyrë efektive në Axhendën e zhvillimit të Post-2015, si pavarësia e SAI-ve, kapacitet e nevojshme profesionale të SAI-ve për të audituar objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, mandatin e nevojshëm, etj.

Një nga çështjet që tërhoqi vëmendjen e pjesëmarrësve ishte edhe diskutimi mbi rolin që mund të luajnë SAI-t, veçanërisht nëpërmjet auditimeve të Performancës dhe trajtimit të temave jo-ekonomike. Është krijuar ideja që SAI-t auditojnë vetëm probleme të karakterit ekonomik si borxhin publik, qëndrueshmërinë e financave publike, etj por aktualisht SAI-t janë fokusuar edhe në drejtim të auditimit të çështjeve jo-ekonomike si p.sh cilësia e arsimit parashkollor, kujdesi për të moshuarit, kujdesi për florën dhe faunën, lufta kundër thatësisë, trajtimi i mbetjeve të rrezikshme për shëndetin e qytetarëve, energjia alternative, etj. Aktualisht, jo vetëm subjektet përgjegjëse për këto çështje por edhe qeveritë respektive, mediat dhe publiku i gjerë janë familjarizuar me trajtimin e temave të tilla nga SAI-t dhe rezultatet e auditimit në këto fusha vlerësohen dhe SAI-t konsiderohen si partnerë të rëndësishëm në diskutimin e temave që lidhen me të ardhmen e shërbimeve publike.

SAI-t gjatë punë së tyre audituese, nuk vënë në dyshim politikat e miratuara nga qeveritë, por fokusohen në vlerësimin e zbatimit të tyre në praktikë, cilat janë pasojat e zbatimit të tyre dhe defektet. SAI-t në këtë proces duhet të

ruajnë objektivitetin për të siguruar besueshmërinë e raporteve të tyre të auditimit. Në dhjetë vitet e fundit, auditimet e Performancës, kanë mbuluar fusha të rëndësishme që lidhen me të ardhmen e shërbimeve publike si sigurimet shoqërore, shëndetësore, sistemin e pensioneve, kujdesin për ruajtjen e mjedisit në shërbimet publike (transport, shëndetësi, sigurinë ushqimore, trajtimin e mbetjeve, etj.). Këto auditime, u sigurojnë SAI-ve pozitën e të qenit një institucion që kupton pasojat sociologjike dhe mjedisore dhe që këto politika janë pjesë integrale e aktiviteteve të qeverisë dhe ndikojnë në shpejtësinë dhe shkallën e zhvillimit të qëndrueshëm.

Roli i aktivitetit ekonomik, si privat edhe publik, për zhvillimin e qëndrueshëm është që të respektojë të tre shtyllat, ekonomike, sociale, mjedisore. Kjo përgjegjësi nuk duhet të konsiderohet si një pengesë, por si një mundësi për zhvillimin e ekonomisë. Shumë kompani kanë integruar tashmë vizion duke zhvilluar, ndër të tjera, politika transparente të "përgjegjësive sociale të korporatave/kompanive". **Shtylla ekonomike** kërkon të realizojë performancën financiare, por mund të kontribuojë gjithashtu në zhvillimin ekonomik afatgjatë. Qeveritë kanë rolin e tyre për të kontribuar që aktiviteti ekonomik të sjellë mirëqenie për të gjithë, dhe jo një pakice të planetit tonë. **Shtylla sociale**, në qoftë se punonjësit duhet të respektohen dhe të paguhen në raport me punën e kryer, kjo duhet të jetë e vërtetë për të gjitha kategoritë e punonjësve. Kompanitë, sindikatat dhe shoqatat duhet vazhdimisht të kërkojnë mbrojtjen e interesit të përgjithshëm. **Shtylla mjedisore** është e lidhur ngushtë me ekonominë: aktivitetet e biznesit mund të jetë në përputhje me ruajtjen e ekosistemit. Një analizë e drejtë nga qeveritë dhe OJQ-të e ndikimit ekonomik në planet,

veçanërisht në drejtim të konsumimit të burimeve dhe menaxhimit të mbeturinave, do të na jepte liri për të vepruar, në rast se konstatojmë abuzimet.

Zhvillimi i qëndrueshëm ka një avantazh që sjell shume avantazhe të tjerë: ai kërkon pjesëmarrjen e të gjithë për të krijuar një botë më të mirë, më të drejtë, duke respektuar mjedisin dhe planetin në tërësi. Zhvillimi ekonomik është një kusht i nevojshëm për të pasur një shoqërie të qëndrueshme dhe një mjedis të shëndetshëm.

Në një situatë të rritjes së konkurrencës, faktorë të rinj, cilësorë, luajnë një rol të rëndësishëm në përzgjedhjen e vend-ndodhjes së kompanive si për shembull ata që lidhen me nivelin e formimit të fuqisë punëtore dhe të cilësisë së jetës. Prandaj në kontekstin aktual, menaxhimi i mirë i mënyrës së jetesës lidhet pazgjidhshmërisht me mbrojtjen e mjedisit, konkurrencën ekonomike dhe solidaritetin njerëzor.

Në një botë ku 20% e popullsisë botërore konsumon 80% të burimeve natyrore, zhvillimi i qëndrueshëm duket mjaft utopik, pothuajse i pamundur. Si mund të arrijmë që 50% e popullsisë të përdorë 50% të burimeve natyrore, në qoftë vendet e pasura nuk detyrohen të heqin dorë nga monopolet e tyre? Në një kontekst të rritjes së krizës klimatike, zhvillimi i qëndrueshëm duket sikur është një katalog shumë i bukur por me produkte shumë të shtrenjta. Megjithatë, është e vetmja përgjigje e mundshme për problemet e sotme në botë. Përballë pabarazive, vetëm respektimi i të drejtave themelore për të gjithë dhe aksesit për të gjithë në një nivel

ekonomik bazë është zgjidhja. Me pak fjalë, zhvillimi i qëndrueshëm nuk është zgjidhje e përkryer, por ajo është e vetmja zgjidhje.

Të gjitha këto arsye kanë bërë që raportet e SAI-ve mbi auditimet e performancës të jenë një pikë e rëndësishme e diskutimit të parlamenteve dhe publikut dhe në shumë vende SAI-ve u sugjerohet të kryejnë auditime në fusha të rëndësishme dhe sensitive (që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm) jo vetëm nga organizatat joqeveritare dhe publiku i gjerë, por edhe nga vetë qeveritë, për rrjedhojë SAI-t të mund të kontribuojnë ndjeshëm në ruajtjen e zhvillimit të qëndrueshëm për sa kohë që pozicioni i tyre i pavarur dhe profesional është i garantuar.

Kombet e Bashkuara dhe komuniteti i INTOSAI-t i kanë dhënë një rëndësi tejet parësore avancimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe trajtimi i kësaj teme në Simpoziumin e 23-të të Kombeve të Bashkuara dhe INTOSAI-t e përforcon këtë fakt dhe për më tepër thekson rolin që mund të luajnë Institucionet Supreme të Auditimit në këtë drejtim.